



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

NR. 26 DATË, 06 . 09. 2008

PËR

**STRUKTURËN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E ZYRËS SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Me synim,

- caktimin e strukturës në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm;
- organizimin dhe përcaktimin e funksioneve të të gjitha hallkave të kësaj Zyre;
- përmirësimin e funksionimit të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe rritjen e nivelit cilësor të kontrollit dhe ndihmës metodike për Prokuroritë e shkallës së parë dhe të apeleve;

Në mbështetje, të nenit 118 e vijues të Kushtetutës, të nenin 9 pika 2 e vijues të ligjit nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10.07.2003,

URDHËROJ:

I. CAKTIMI I STRUKTURËS DHE ORGANIZIMI I ZYRËS TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

A. Organizimi i strukturës funksionale të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të jetë, si më poshtë¹:

1. Kabineti i Prokurorit të Përgjithshëm, i përbërë nga:

- 1.1. Këshilltarët;
- 1.2. Zëdhënës

2. Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale, e përbërë nga:

- 2.1. Sektori Kundër Krimit të Organizuar;
- 2.2. Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit;
- 2.3. Sektori Kundër Veprave Penale të tjera dhe për të Mitur;

3. Drejtoria Gjyqësore

¹ Shih, organigramën e strukturës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, bashkëlidhur.

4. Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, e përbërë nga:

- 4.1 Sektori i Inspektimit;
- 4.2 Sektori i Burimeve Njerëzore;
- 4.3 Sektori i Marrëdhënieve me Publikun.

5. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

6. Drejtoria e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit, e përbërë nga:

- 6.1. Sektori i përgatitjes së projekt-akteve normative, analizës dhe studimeve;
- 6.2. Sektori i Kërkimeve Ligjore/Jurispondencës Gjyqësore Krahasuese dhe Integritit;
- 6.3. Sektori i Statistikës

7. Sektori i Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative.

8. Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Mbikëqyrjes së Vuajtjes së Dënimit.

B. Numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe specialistëve, si dhe drejtorët dhe shefat e sektorëve, caktohen me urdhër të veçantë të Prokurorit të Përgjithshëm.

II. FUNKSIONET E KABINETIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM DHE PËRBËRJA E TIJ

1. Kabineti i Prokurorit të Përgjithshëm, ka funksione:

1.1 Përgatit programin ditor dhe takimet e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe ndjek zbatimin e tij;

1.2 Nxjerr, përpunon dhe i vë në dispozicion të dhënat e kërkuara Prokurorin e Përgjithshëm;

1.3 Përgatit dhe bashkërendon marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm me strukturat vartëse Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokuroritë e të gjitha niveleve;

1.4 Përgatit projekt-raporte, projekt-informime ose projekt-njoftime të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose institucione të tjera, duke bashkërenduar me të gjitha hallkat e strukturës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm;

1.5 Organizon dhe ndjek marrëdhëniet me jashtë të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe përgatit udhëtimet jashtë shtetit të tij, duke bashkërenduar dhe me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë;

1.6 Kujdeset për të siguruar ndihma të huaja për nevojat e Prokurorisë, nëpërmjet aplikimeve, si dhe koordinon dhe kontrollon zbatimin e

programeve të huaja për prokurorinë;

1.7 Mban lidhje me institucionet vendase, organizmat dhe misionet ndërkombëtare dhe institucionet homologe të vendeve të ndryshme, si dhe trupat diplomatikë të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

1.8 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit të kësaj Zyre dhe institucionet homologe të huaja për përhapjen jashtë shtetit të Sistemit Ligjor të Prokurorisë Shqiptare;

1.9. Mban lidhje me zëdhënësit e shtypit të Prokurorive aty ku ka dhe me drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, për të rehat që duhet t'i njoftohen publikut, si dhe ndjek në vazhdimësi programimin dhe informacionet për publikun në faqen e internetit të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

1.10 Nxjerr çdo ditë problemet lidhur me kriminalitetin ose që prekin prokurorinë nga media elektronike dhe ajo e shkruar, të cilat në formë të përmbledhur ia bën të njohur Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Kabineti ka në përbërje:

2.1. Drejtorin e Kabinetit;

2.2. Këshilltarët:

a) për marrëdhëniet e Prokurorisë me institucionet e tjera shtetërore dhe autoritet e huaja, si dhe për marrëdhëniet me publikun dhe media;

b) për probleme ligjore

2.3. Zëdhënës

III. FUNKSIONET E DREJTORISË SË KONTROLLIT TË HETIMIT DHE TË NDJEKJES PENALE DHE PËRBËRJA E SAJ

1. Drejtoria e Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale, sipas strukturës të caktuar në **pikën 1-A/2** të këtij urdhri, për grup veprat penale që mbulojnë sektorët në përbërje të saj, ka kompetenca dhe është përgjegjëse, sa më poshtë:

1.1 Ushtron ndjekje penale ose përfaqëson akuzën në gjyq për vepra penale të kryera nga Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë², me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm.

1.2 Kontrollon efektivitetin dhe ligjshmërinë në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale në hetimet paraprake nga prokurorët dhe policia gjyqësore në Prokuroritë e shkallës së parë, për respektimin e ligjit dhe të urdhrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshme, si dhe merr pjesë në inspektimet që kryen për ndjekjen penale në hetim, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe struktura të tjera të kësaj Zyre.

1.3 Ndjek në dinamikë ecurinë e procedimeve penale në hetimet paraprake në Prokuroritë e shkallës së parë, ndihmon nga ana metodike, prokurorët më të ulët dhe oficerët e policisë gjyqësore, sipas grup veprave dhe drejtimet që mbulojnë, veçanërisht për procedime të rëndësishme, të vështirësisë së veçantë ose për krime të rënda dhe sensitive, duke

² Po aty, neni 75/b-2

analizuar dhe urdhëruar apo udhëzuar më shkrim kryerjen e detyrave, të detyrueshme për zbatim, për realizimin e një procedimi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor;

1.4 Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve të gjendjes, përhapjes, tendencave të kriminalitetit dhe të efektivitetit e ligjshmërisë në ndjekjen penale, jep mendime për përgatitjen e projektudhëzime orientuese për prokurorët, lidhur me politikën e ndjekjes penale në hetimet paraprake që duhet të zbatohen në vitin në vijim në shkallë vendi, për grup vepra ose për vepra penale të veçanta, që kanë qenë më të përhapura ose më shqetësuese apo që kanë patur e kanë tendencë në rritje;

1.5 Kontrollon aktivitetin procedural penal të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit dhe të gjitha llojeve të tjera të policive kur ato ushtrojnë funksionet e policisë gjyqësore, si dhe mbikëqyr, udhëheq nga ana metodike dhe bashkërendon veprimtarinë e policisë gjyqësore, me synim rritjen e efektivitetit të saj, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm;

1.6 Përgatit pjesë nga projekt-raportet ose projekt-informimet periodike për çështje të kërkuara lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale në hetimet paraprake, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së ose institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.7 Shqyrton ankimet e paraqitura tek Prokurori i Përgjithshëm:

- a) për zëvendësimin e prokurorit apo oficerin e policisë gjyqësore në fazën e hetimeve paraprake³;
- b) për konfliktet e kompetencës lëndore ose tokësore ose për konfliktet lidhur me kërkimin dhe/ose kalimin e akteve, që lindin ndërmjet prokurorive në fazën e hetimeve paraprake⁴;
- c) për marrjen përsipër të hetimeve, kur prokurori i rrethit gjyqësor nuk e ushtron ndjekjen penale dhe/ose nuk e pushon çështjen në afatin e caktuar⁵;

duke përgatitur projekt-aktet procedurale penale përkatëse, për zgjidhjet ligjore që i rekomandohen Prokurorit të Përgjithshëm.

1.8 Shqyrton ankimet e paraqitura kundër vendimit të mosfillimit të procedimit dhe/ose kundër vendimit të pushimit të akuzës apo çështjes⁶, në rastet kur këto vendime nuk janë ankimuar dhe shqyrtuar në gjykatë, duke vendosur për zgjidhjen ligjore të tyre⁷

1.9 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit dhe Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, për të iniciuar trajnimet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për të rritur kapacitet në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale në hetimet paraprake.

1.10 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit, për të iniciuar përgatitjen e projekt-akteve normative, studimeve

³ Po aty, neni 27 paragrafët 2 e 3

⁴ Po aty, neni 28/2, 29/2 e 89 paragrafi 2

⁵ Po aty, neni 305

⁶ Po aty, neni 329/1, 291/2 e 24/5

⁷ Shih, Urdhrin e PP nr , datë , 01. 2008 "Për caktimin e shkallës së hierarkisë në Prokurori"

dhe analizave që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale në hetimet paraprake.

1.11 Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Në ushtrimin e kompetencave të saj, kjo drejtori bashkërendon me hallkat e tjera të kësaj Zyre dhe me Prokuroritë e shkallës së parë, për ushtrimin sa më mirë të funksioneve në ndjekjen penale në hetimet paraprake, si dhe informon në vazhdimësi Prokurorin e Përgjithshëm për shkelje të ligjit penal dhe procedural penal të evidentuara gjatë udhëheqjes metodike ose kontrollit të hetimeve dhe ndjekjes penale në këtë fazë, duke propozuar iniciimin e fillimit të procedimit disiplinorë ndaj prokurorëve ose oficerëve/agjentëve të policisë gjyqësore përkatës.

3. Hallkat e kësaj drejtorie të organizuara në sektor sipas grup veprave penale kryejnë detyrat, si më poshtë:

3.1 Sektori Kundër Krimit të Organizuar është përgjegjës në ushtrimin e funksioneve, për krimin e organizuar dhe për krime të rënda, që përcaktohen në nenin 75/a të K. Pr. Penale.

3.2 Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit është përgjegjës në ushtrimin e funksioneve për veprat penale kundër krimit ekonomik, korrupsionit, në sferën ekonomike dhe në detyrë, të përcaktuara në **aneksin Nr. 1**, bashkëlidhur.

3.3 Sektori Kundër Vepra Penale të Tjera, si dhe për të Mitur është përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve për veprat penale të tjera, si dhe për veprat penale të kryera nga të miturit.

4. Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale, ka në përbërje:

4.1 Drejtorin - prokuror - të Drejtorisë së Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale;

4.2 Sektori Kundër Krimit të Organizuar;

- Prokurorët Kundër Krimit të Organizuar;

4.3 Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit;

- Prokurorët Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit;

4.4 Sektori Kundër Veprave Penale të tjera dhe për të Miturit;

- Prokurorët Kundër Vepra Penale të tjera dhe për të Miturit;

IV. FUNKSIONET E DREJTORISË GJYQËSORE DHE PËRBËRJA E SAJ

1. Drejtoria Gjyqësore, sipas strukturës të caktuar në **pikën 1-A/3** të këtij urdhri, për drejtimin që mbulon ka kompetenca dhe është përgjegjëse, sa më poshtë:

1.1 Ushtron funksionet pranë Gjykatës së Lartë në gjykimin e çështjeve kur është ushtruar:

- a) rekurs kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë⁸ dhe/ose;
- b) rekurs kundër vendimeve gjyqësore që disponohet mbi lirit personale dhe mosmarrëveshjet juridiksionale apo kompetence

⁸ K. Pr. Penale, neni 432

lëndore ose tokësore⁹;

1.2 Përfaqëson Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese dhe në çdo lloj gjykimi ku ajo është thirrur si palë;

1.3 Ushtron ndjekje penale ose përfaqëson akuzën në gjyq për vepra penale të kryera nga Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë¹⁰, me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm.

1.4 Kontrollon ligjshmërinë dhe efektivitetin në ushtrimin e funksioneve në ndjekjen penale në gjykim nga prokurorët e Prokurorive të shkallës së parë dhe Prokurorive të Apeleve, si dhe merr pjesë në inspektimet që kryen për ndjekjen penale në gjykim, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe struktura të tjera të kësaj Zyre;

1.5 Ndjek në dinamikë ecurinë e ndjekjes penale në gjykim dhe ushtrimin e të drejtës së ankimit në Prokuroritë e të gjitha niveleve, duke urdhëruar me shkrim ose ushtruar vetë të drejtën e ankimit në rastet kur nuk është ushtruar prej tyre, si dhe duke udhëhequr nga ana metodike dhe ndihmuar prokurorët për respektimin e parimeve të procedimit të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor në këtë fazë të procedimit penal;

1.6 Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve të gjendjes, përhapjes, tendencave të kriminalitetit dhe të efektivitetit dhe ligjshmërisë në ndjekjen penale në gjykim, jep mendime për përgatitjen e projekt-udhëzimit orientues për politikën e ndjekjes penale në gjykim, të kërkesave për lloje e masa dënimi që duhet të zbatohen nga prokurorët e shkallës së parë dhe të apeleve në shkallë vendi, për grup vepra ose për vepra penale të veçanta, që kanë qenë më të përhapura ose më shqetësuese apo që kanë patur e kanë tendencë në rritje;

1.7 Përgatit pjesë nga projekt-raportet ose projekt-informimet periodike për çështje të kërkuara lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale në gjykim, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së ose institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.8 Shqyrton ankesat e ardhura lidhur me çështjet në gjykim ose të gjykuara, duke vendosur për zgjidhjen e duhur ligjore¹¹.

1.9 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritetit dhe Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, për të iniciuar trajnimet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për të rritur kapacitetin në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim.

1.10 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritetit, për të iniciuar përgatitjen e projekt-akteve normative, studimeve dhe analizave që lidhen me ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim.

1.11 Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj dhe me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Në ushtrimin e kompetencave të saj, kjo drejtori bashkërendon me hallkat e tjera të kësaj Zyre dhe me Prokuroritë e shkallës së parë dhe

⁹ Po aty, nenet 86/2, 249/8,10 e vijues

¹⁰ Po aty, neni 75/b-2

¹¹ Shih, Urdhri i PP nr. , datë , 01. 2008 "Për caktimin e shkallës së hierarkisë në Prokurori"

Prokuroritë e apeleve, për ushtrimin sa më mirë të funksioneve në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës gjykim, si dhe informon në vazhdimësi Prokurorin e Përgjithshëm për shkelje të ligjit penal dhe procedural penal të evidentuara gjatë udhëheqjes metodike ose kontrollit të ndjekjes penale në gjykim, duke propozuar inicimin e fillimit të procedimit disiplinor ndaj prokurorëve ose oficerëve/agjentëve të policisë gjyqësore përkatës.

3. Drejtoria Gjyqësore ka në përbërje:

3.1 Drejtorin - prokuror - të Drejtorisë Gjyqësore;

- Prokurorët e Drejtorisë Gjyqësore;

V. FUNKSIONET E DREJTORISË SË INSPEKTIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE, SI DHE PËRBËRJA E SAJ

1. Drejtoria e Inspektimit dhe Personelit, sipas strukturës të caktuar në **pikën 1-A/4** të këtij urdhri, për drejtimet që mbulojnë secili sektor në përbërje të saj, ka kompetencat dhe është përgjegjës, sa më poshtë:

1.1 Sektori i Inspektimit, kryen funksionet:

1.1.1. Përgatit planin vjetor të inspektimeve të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, duke parashikuar kryerjen e inspektimeve të plota në çdo prokurori jo më pak se një herë në dy vjet;

1.1.2. Organizon dhe kryen sipas planit, inspektime në çdo prokurori, si dhe inspektime të pjesshme për grup veprash penale apo procedimesh ose për procedime të veçantë, duke bashkërenduar me strukturat e tjera të kësaj Zyre, sipas kompetencave të përcaktuar në këtë urdhër;

1.1.3. Bën vlerësimin paraprak të aftësive profesionale për secilin prokuror dhe ia paraqet për shqyrtim Këshillit të Prokurorisë;

1.1.4. Kryen inspektime dhe hetime, me qëllim verifikimin e shkeljeve të natyrës disiplinore të prokurorëve, si dhe përgatit dhe paraqet për shqyrtim në Këshillin e Prokurorisë akuzën disiplinore dhe dokumentacionin e nevojshëm për masa disiplinore të prokurorëve;

1.1.5. Merr në shqyrtim dhe vlerëson sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me inspektimet e kryera në organe të Prokurorisë;

1.1.6. Kryen procedurat përkatëse për deklarimin e pasurive të prokurorëve, juristëve të seksionit të policisë gjyqësore në prokurori dhe subjekteve të tjera, në zbatim të ligjit¹²;

1.1.7. Përgatit materialet dhe njoftimet për mbledhjet e Këshillit të Prokurorisë, ia paraqet për miratim Prokurorit të Përgjithshëm dhe me autorizimin e tij paraqet materialet në këtë Këshillë;

1.1.8. Ndjek zbatimin e rregullave të etikës nga prokurorët dhe juristët-oficer të policisë gjyqësore, të gjithë niveleve të Prokurorive, si dhe nga punonjësit me statusin e nëpunësit civil dhe punonjësit e tjerë, si dhe njofton Prokurorin e Përgjithshëm për rastet e shkeljeve, duke rekomanduar masat e nevojshme;

1.1.9. Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve të inspektimeve dhe të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve, jep mendime për përgatitjen e projekt-udhëzimit orientues për përmirësimin e aftësive profesionale të **prokurorëve**;

¹² Shih, ligjin Nr. 9363, datë 7. 04. 2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"

1.1.10. Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

1.2. Sektori i Burimeve Njerëzore, kryen funksionet:

1.2.1. Administron dokumentacionin me të dhënat vetjake të kandidatëve për prokurorë, prokurorëve, juristëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore, të nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë në organin e Prokurorisë;

1.2.2. Përgatit dokumentacionin përkatës për emërimë, transferime, ngritje në detyrë dhe shkarkime të prokurorëve, juristëve - oficerë të policisë gjyqësore të Prokurorive dhe punonjësve të tjerë të kësaj Zyre dhe të Prokurorive të të gjitha niveleve që janë emërtesë e Prokurorit të Përgjithshëm;

1.2.3. Administron trajnimet periodike vazhduese të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore, për ngritjen e nivelit profesional të tyre, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit të kësaj Zyre dhe me Shkollën e Magjistraturës, si dhe me pjesëmarrësit në trajnime;

1.2.4. Harton programet e trajnimit të administratës së Prokurorive, bazuar në prioritetet ose shqetësimet e praktikës dhe administron dokumentacion përkatës;

1.3. Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, kryen funksionet:

1.3.1. Merret me pritjen e ankesave, shqyrtimin dhe relatimin Prokurorit të Përgjithshëm për zgjidhje të ankesave dhe kërkesave që janë në kompetencën e tij ose të Zyrës së tij.

1.3.2. Për ankesat dhe kërkesat që nuk janë në kompetencë për zgjidhje të kësaj Zyre, sipas rastit i kthehet përgjigje zyrtare të interesuarit, duke informuar me shkrim për zgjidhjen Prokurorin e Përgjithshëm.

1.4. Sektorët e kësaj drejtorie, gjithashtu, përgatisin pjesë nga projekt-raportet ose projekt-informimet periodike për çështje të kërkuara lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së ose institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.5. Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore ka në përbërje:

1.5.1. Drejtorin prokuror të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore;

1.5.2. Sektorin e Inspektimit;

- Prokurorët e Inspektimit.

1.5.3. Sektorin e Burimeve Njerëzore;

- Specialist të këtij sektori.

1.5.4. Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun;

- Specialist - jurist - të këtij sektori.

VI. FUNKSIONET E DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË, SI DHE PËRBËRJA E SAJ

1. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, sipas strukturës të caktuar në **pikën 1-A/5** të këtij urdhri, ka kompetenca dhe

është përgjegjës për të ndihmuar nga ana metodike dhe mbikëqyrur veprimtarinë e Prokurorive të të gjitha niveleve në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, si më poshtë:

1.1. Për plotësimin korrekt të kërkesave: për ekstradim, transferim procedimi, letër-porosi ndërkombëtare, ekzekutim të vendimeve penale të huaja dhe akte të tjerë në këtë fushë;

1.2. Ndjek në dinamikë dhe kontrollon realizimin sa më efektiv dhe në afat të marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja;

1.3. Është pikë kontakti dhe bashkërendon me drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshme dhe me institucione të tjera, të vendit ose të huaja, për të ndjekur ecurinë e zgjidhjes ligjore të procedimeve penal ose të ekzekutimit të vendimit penal në këtë fushë.

1.4. Kujdeset për të siguruar përkthimet dhe përkthyesit për materialet dhe fashikujt e procedimeve në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja;

1.5. Organizon vendosjen e kontakteve dhe takimeve të rregullta ndërmjet prokurorëve të rretheve kufitare me prokurorët e vendeve fqinj dhe me prokurorë të vendeve të tjera;

1.6. Harton listën e kontakteve/adresave, duke dhënë emrat e personave pikë kontakti, në autoritetet e tjera proceduese ose nivele të ndryshme prokurorie, fushat e specialiteteve dhe përgjegjësitë e tyre;

1.7. Organizon udhëtimet zyrtare të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore jashtë vendit dhe të homologëve të huaj në Shqipëri, në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja, duke hartuar dhe mbajtur programet dhe protokollet e nevojshme;

1.8. Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, jep mendime për përgatitjen e projektudhëzime orientuese për prokurorët, lidhur përmirësimin e treguesve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja;

1.9. Përgatit pjesë për projekt-raportet ose projekt-informimet periodik për çështje të kërkuara lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.10. Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit dhe Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, për të iniciuar trajnimet për ngritjen profesionale të prokurorëve për të rritur kapacitet në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

1.11. Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit, për të iniciuar përgatitjen e projekt akteve normative, studimeve dhe analizave që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

1.12. Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Drejtoria e Marrëdhënieve juridiksionale me Jashtë ka në përbërje;

2.1 Drejtorin e Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë;

a. Oficer të Policisë Gjyqësore - Jurist;

b. Specialist-Jurist të këtij sektori;

c. Përkthyes.

VII. FUNKSIONET E DREJTORISË SË STUDIMEVE, KËRKIMEVE LIGJORE DHE INTEGRIMIT, SI DHE PËRBËRJA E SAJ

1. Drejtoria e Studimeve, Kërkimeve ligjore dhe Integrimit, sipas sektorëve të përcaktuar në **pikën 1-A/6** të këtij urdhri, për drejtimet që mbulojnë secili sektor në përbërje të saj, ka kompetenca dhe është përgjegjës, sa më poshtë:

1.1 Sektori i përgatitjes së projekt-akteve normative, analizës dhe studimeve, kryen funksione:

1.1.1. Përgatit projekt-aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm ose të përbashkëta me institucione të tjera, si: rregullore, urdhra, udhëzime, për përmbushjen e detyrimeve ligjore ose të nevojave që dikton unifikimi i praktikës në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve apo policisë gjyqësore ose të nevojave të bashkërendimit ndërinstitucional;

1.1.2. Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve të gjendjes, përhapjes, tendencave të kriminalitetit dhe të efektivitetit dhe ligjshmërisë në ndjekjen penale në hetim dhe gjykim, si dhe në ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, pasi merr mendime nga drejtorit dhe sektorët e tjerë të kësaj Zyre, përgatit projektudhëzime orientuese për prokurorët, lidhur me politikën e ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe në gjykim, të kërkesave për lloje e masa dënimi që duhet të zbatohen në shkallë vendi, për grup vepra ose për vepra penale të veçanta, që kanë qenë më të përhapura ose më shqetësuese apo që kanë patur e kanë tendencë në rritje, me synim unifikimin e politikës së procedimit dhe të kërkesave për lloje e masa dënimi në gjykatë, si dhe rritjen e efektivitetit dhe forcimin e ligjshmërisë në ndjekjen penale dhe në ekzekutimin e vendimeve penale;

1.1.3. Inicion në Ministrin e Drejtësisë, propozime për ndryshimet e nevojshme të akteve ligjore ose nënligjore, që lidhen me veprimtarinë e Prokurorisë dhe reformën në sistemin e drejtësisë penale, bazuar në kërkimet, analizat dhe studimet përkatëse;

1.1.4. Studion, projekt aktet ligjore e nënligjore, që vijnë për mendim në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera, duke parashtruar sugjerime, për ndryshime, plotësime apo redaktimet dhe/ose duke bërë vërejtjet përkatëse;

1.1.5. Kryen studime, analiza dhe përgjithësime ose qarkore, për treguesit më sintetik të punës së prokurorisë dhe të gjendjes, përhapjes dhe tendencave të kriminalitetit në shkallë vendi ose rrethi gjyqësor, si dhe për përvojën negative ose pozitive të praktikës së prokurorisë apo policisë gjyqësore, me synim unifikimin e praktikës së prokurorisë e policisë gjyqësore dhe forcimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e tyre në shkallë vendi, si dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut në procesin penal;

1.1.6. Në bashkërendim me hallkat e strukturës së kësaj Zyre, përgatit pjesë të projekt-raporteve ose projekt-informimeve periodike apo mendime për çështje të kërkuara, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së apo institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.1.7. Sugjeron nevojat trajnuese që evidentohen në praktikën e ushtrimit të funksioneve të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore dhe bashkërendon me Shkollën e Magjistraturës për organizimin e trajnimeve periodike vazhduese të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore, me synim ngritjen e nivelit profesional të tyre, si dhe bashkërendon me Drejtorin e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, për të administruar pjesëmarrësit në këto trajnime;

1.1.8. Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

1.2. Sektori i Kërkimeve Ligjore/Jurispondencës Gjyqësore Krahasuese dhe Integritit, kryen funksione:

1.2.1. Kryen kërkime ligjore krahasuese dhe studime të Jurispondencës gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare,

- duke nxjerr komente dhe informacione, për të rejat në fushën penale, që për afrojnë me legjislacionin tonë penal dhe procedural penal dhe ia bëjnë të njohur prokurorëve të gjithë niveleve, si dhe;
- duke bërë studime krahasuese të legjislacioneve dhe Jurispondencës gjyqësore penale, në marrëdhënie me institucione/autoritete ligjore homologe, universitete të huaja ose me pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare;

1.2.2. Ndjek në dinamik praktikën gjyqësore penale dhe dërgimin në Prokuroritë e të gjithë niveleve të vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në fushën penale;

1.2.3. Ndihmon Prokuroritë e të gjitha niveleve në çështjet ligjore, duke mbledhur dhe përpunuar informacione ligjore mbi legjislacionin e brendshëm, të huaj dhe ndërkombëtar, si dhe shpërndan informacione që lidhen me krahasimin e sistemeve ligjore në fushën penale;

1.2.4. Përgatit informime periodike për progresin e Prokurorisë në përmbushjen e angazhimeve në kuadrin e MSA-së;

1.2.5. Përgatit materialet dhe përfaqëson Prokurorinë në nivel ekspertësh në takimet e përbashkëta Task-Forcë, BE-Shqipëri.

1.2.6. Informon Prokuroritë e të gjithë niveleve, mbi angazhimin e vendin tonë lidhur me Çështjet e Drejtësisë dhe të Brendshme, në kuadrin e angazhimeve për anëtarësim në BE, si dhe lidhur me detyrimet praktike që i dalin Prokurorisë në kuadrin e integritit;

1.2.7. Përgatit, boton dhe shpërndan studime për çështje të veçanta të së drejtës, për probleme të zbatimit praktik të ligjit, si dhe kujdeset për çdo botim tjetër të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm ose të Prokurorit të Përgjithshëm;

1.3. Sektori i Statistikës, kryen funksione:

1.3.1 Kujdeset për saktësinë e të dhënave statistikore të ardhura nga Prokuroritë e të gjithë niveleve.

1.3.2 Përpunon dhe nxjerr të dhënat statistikore të prokurorive në të gjithë nivelet, sipas periudhave: 1 mujore, 3-mujore, 6-mujore 9-mujore dhe vjetore;

1.3.3 Përgatit informacione për Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtorit ose

sektorët e kësaj Zyre, lidhur me treguesit e punës në Prokuroritë e të gjithë niveleve dhe treguesit e kriminalitetit, duke tërhequr konkluzione për gjendjen, shtrirjen dhe tendencat e veprave penale, si dhe për treguesit e punës së Prokurorisë, sipas organizimit dhe niveleve të saj.

1.3.4 Studion dhe vlerëson gjendjen e sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe dokumentimit të të dhënave statistikore, si dhe bën propozime për projekte përmirësuese.

4. Drejtoria e Studimit, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit, ka në përbërje:

4.1 Drejtorin e Drejtorisë së Studimeve, Kërkimeve ligjore dhe integritit.

4.2 Sektori i Projekt-akteve Normative, Studimeve dhe Analizës

- Specialist-Jurist të këtij sektori;

4.3 Sektori i Kërkimeve Ligjore/Jurisprudencës Gjyqësore Krahasuese dhe Integritit

- Specialist-Jurist të këtij sektori

4.4 Sektori i Statistikës

- Specialist të Statistikës.

VIII. FUNKSIONET E SEKTORIT TË PËRGJIMEVE TË TELEKOMUNIKIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME SHËRBIMET INFORMATIVE, SI DHE PËRBËRJA E TIJ

1. Sektori i Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, ka kompetenca dhe është përgjegjës, sa më poshtë:

1.1 Të pranojë autorizime për kryerjen e përgjimit të telekomunikimeve të ardhura nga Prokuroritë e shkallës së parë - me vendim gjykate ose me vendim të prokurorit në raste emergjente - dhe ti dërgojë menjëherë ato për veprim në Bërthamën Komanduese Elektronike (BKE) me një akt zyrtar të posaçëm.

1.2 Të udhëheqë, të ndihmojë nga ana metodike, të ndjekë në dinamikë dhe të kontrollojë respektimin e ligjshmërisë, në Prokuroritë e të gjithë niveleve, në Bërthamën Komanduese Elektronike (BKE-në) dhe në Sektorin e Përgjimeve në SHISH, për realizimin e përgjimit të telekomunikimeve të autorizuara nga gjykata ose nga prokurori në raste emergjente, si dhe të përgjimit të fshehtë fotografik, filmik ose me video të personave në vende publike dhe përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes të autorizuar nga prokurori:

a. duke kontrolluar ligjshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të këtij mjeti të posaçëm të kërkimit të provës, nëpërmjet inspektimeve të plota ose të pjesshme si sektor dhe/ose në bashkërendim me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të kësaj Zyre, lidhur me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë;

b. duke kontrolluar çdo muaj veprimtarinë e Bërthamës Komanduese Elektronike, për gjendjen faktike të autorizimeve për përgjim, të përgjimeve të realizuara dhe të përgjimeve në proces, duke i specifikuar me vendim të gjykatës dhe/ose me vendim të prokurorit, si dhe;

c. duke informuar Prokurorin e Përgjithshëm për mangësitë dhe shkeljet e evidentuara, si dhe duke propozuar masat që duhen marrë dhe personat përgjegjës.

1.3. Me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, verifikon ligjshmërinë e kërkesave për përgjim parandalues¹³ që i paraqiten Prokurorit të Përgjithshëm nga subjektet e përcaktuara me ligj dhe përgatit projekt-aktet përkatëse, si dhe evidenton, ndjek dhe kontrollon procedurat për kryerjen e përgjimit të telekomunikimeve në BKE dhe në Sektorin e Përgjimeve në SHISH, në zbatim të aktit normativ të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të SHISH-it në fuqi.

1.4. Me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, kontrollon ligjshmërinë e projekt-akteve për procedurat e veprimtarisë së shërbimeve informative¹⁴ (SHISH-it, SHIU-t, SHKB-së, SHKBB-së) që i propozohen për miratim Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe kontrollon zbatimin e tyre.

1.5. Të realizojë konsulta teknike dhe këshilluese, si dhe të udhëheqë nga ana metodike Prokuroritë e të gjitha niveleve, lidhur me marrëdhëniet me shërbimet informative, si SHISH-in, SHIU-së, SHKB-në në Ministrin Brendshme dhe SHKBB-në në Ministrinë e Drejtësisë.

1.6. Të bashkërendojë me drejtuesit e SHISH-it, SHIU-t, SHKB-së në Ministrinë e Brendshme dhe SHKBB-ve në Ministrinë e Drejtësisë dhe/ose me institucione të tjera në këtë fushë, duke ju bërë prezent problemet dhe kërkuar prej tyre marrjen e masave për zbatimin e ligjit.

1.7. Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit dhe Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, për të iniciuar trajnimet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në këtë fushë.

1.8. Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit, për të përgatitur projekt-akte normative, qarkore, studime dhe analiza në këtë fushë.

1.9. Me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, i jap zgjidhje ligjore, ankesave dhe kërkesave, që i vijnë Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me përgjimet procedurale dhe përgjimet parandaluese, si dhe për respektimin e procedurave nga shërbimet informative.

1.10. Të ruaj sekretin e veprimtarisë në këtë sektor, si dhe të administrojë dhe ruajë dokumentacionin sekret që lidhet me procesin e përgjimit dhe aktet e tjera të klasifikuara në marrëdhëniet me shërbimet informative, në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

1.11. Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve lidhur me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit dhe efektivitetin e tyre, jep mendime për përgatitjen e projektudhëzime orientuese për prokurorët, lidhur me përmirësimin e përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit në kërkimin dhe administrimin e provave;

1.12. Përgatit pjesë të projekt-raporteve ose projekt-informimeve periodike për çështje të kërkuara lidhur me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit dhe përgjimin parandalues, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit,

¹³ Shih, ligjin Nr. 9157 datë 4. 12. 2003 "Për përgjimin e telekomunikimeve"

¹⁴ Shih, nenin 6 të ligjit Nr. 8391 datë 28. 10. 1998 "Për Shërbimin Informativ Shtetërorë", nenin 12 të ligjit "Nr. 8749 datë 1. 03. 2001 "Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në M. R. Publik " dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9074 datë 29. 05. 2003 "Për shërbimin informativ ushtarak"

Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë ose institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.13. Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Sektori i Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, ka në përbërje:

2.1 Shefin e Sektorit - prokuror - të Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative;

a) Oficer të Pol. Gjyqësore të Përgjimeve të Telekomunikimit;

b) Specialist ose Of.Pol.Gjyqësore të Bërthamës Komanduese Elektronike.

IX. SEKTORI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT

1. Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Mbikëqyrjes së Vuajtjes së Dënimit ushtron funksionet dhe është përgjegjës, sa më poshtë:

1.1 Urdhëron dhe mbikëqyrin ekzekutimin e vendimeve penale ndaj subjekteve që parashikon neni 75/b pika 2 e K. Pr. Penale, si dhe urdhëron ekzekutimin e vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm të Gjykatës së Lartë dhe të masave të sigurimit të urdhëruara prej saj;

1.2 Ushtron kontrolle për ligjshmërinë dhe efektivitetin në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve, në ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, në Prokuroritë e të gjithë niveleve, si dhe për t'i ndihmuar ata nga ana metodike:

a. duke kryer kontrolle dhe inspektime të plota ose të pjesshme si sektor dhe/ose në bashkërendim me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të kësaj Zyre, lidhur me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve;

b. duke informuar Prokurorin e Përgjithshëm për shkeljet e evidentuara dhe propozuar masat që duhen marrë ndaj personave përgjegjës.

1.3 Ndjek në dinamikë ecurinë e ekzekutimit të vendimeve penale dhe evidenton periodikisht, çdo 3-muaj, gjendjen në shkallë vendi dhe sipas Prokurorive, të vendimeve penale të ekzekutuara, në ekzekutim dhe të paekzekutuara;

1.4 Bashkërendimin me drejtorit ose sektorët përkatës në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe/ose me institucione të tjera në këtë fushë, duke ju bërë prezent problemet dhe kërkuar prej tyre marrjen e masave për zbatimin e ligjit në këtë fazë;

1.5 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit dhe me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore për të iniciuar dhe ndjekur trajnimet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të caktuar për ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit;

1.6 Bashkërendon me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit për të përgatitur, projekt-akte normative, analiza dhe studime në

fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbikëqyrjes së vuajtjes dënimit;

1.7 jep zgjidhje ligjore ankesave dhe kërkesave, që vijnë në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit.

1.8 Në fillim të çdo viti, pas analizës së treguesve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, jep mendime për përgatitjen e projektudhëzime orientuese për prokurorët, lidhur përmirësimin e treguesve të efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve penale dhe forcimin e ligjshmërisë në trajtimin e të dënuarve në përqasje me standardet e pranuar në këtë fushë;

1.9 Përgatit pjesë të projekt-raporteve ose projekt-informimeve periodike për çështje të kërkuara lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, për t'ia dërguar Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë ose institucioneve të tjera, duke bashkërenduar me kabinetin;

1.10 Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, me këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Mbikëqyrjes së Vuajtjes së Dënimit, ka në përbërje:

2.1 Shefin e Sektorit - prokuror - të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Mbikëqyrjes së Vuajtjes së Dënimit

- Oficer të Pol. Gjyqësore;

X. DISA FUNKSIONE TË TJERA TË DREJTUESVE TË ZYRËS SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

1. Drejtuesit e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, krahas funksioneve të përcaktuara sipas hallkave të strukturës në zbatim të këtij urdhri, kryejnë edhe këto funksione:

1.1. Organizojnë dhe dretojnë punën në drejtori dhe sektor, duke përcaktuar detyra për çdo prokuror, oficer të policisë gjyqësore dhe specialist, sipas drejtimeve, si dhe mbikëqyrin zbatimin e tyre;

1.2. Organizojnë analiza ose kërkojnë sqarime apo raportime nga drejtuesit e prokurorive, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe specialistët, në drejtori ose sektor apo në vend, për çështje konkrete, grup çështjesh ose tregues të tjerë të ndjekjes penale, duke lënë detyra ose udhëzime të nevojshme me shtrim. Për problemet që dalin informojnë Prokurorin e Përgjithshëm;

1.3. Kontrollojnë korrespondencën që del nga drejtorja ose sektori, duke e sigluar para se të kalohet për firmë nëpërmjet kabinetit;

1.4. Sigurojnë bashkërendimin e punës ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të kësaj Zyre;

1.5. Kryejnë detyra të tjera që u ngarkohen më këtë urdhër ose me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm.

XI. ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

1. Me këtë urdhër të njihen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësor, nëpunësit civil dhe punonjësit tekniko-administratës, si dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.

2. Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësor, si dhe drejtuesit e strukturës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Prokurorive të të gjithë niveleve.

3. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

XI. DISPOZITA KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

1. Struktura, organizimi dhe funksionimet e punonjësve të shërbimit civil dhe të shërbimeve ndihmëse tekniko-administrative të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, do të përcaktohet me urdhër të veçantë.

2. Shfuqizohen aktet normative, si më poshtë:

2.1 Urdhri nr. 22, datë 23. 01. 2006 "Për përcaktimin e funksioneve të Seksionit të Mbikëqyrjes të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Trajtimin e të Dënuarve";

2.2 Urdhri nr. 34, datë 14. 02, 2006 "Për përcaktimin e funksioneve të Seksionit të Përgjimit të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative",

2.3 Urdhri nr. 138, datë 22. 10. 2001 "Për krijimin e strukturës për drejtimin e hetimeve të procedimeve lidhur me grup veprat penale të rënda", i ndryshuar me urdhrin nr. 94, datë 16. 05. 2002.

3. Ndryshohen, në përqasje me emërtesat e përcaktuara në këtë urdhër, aktet normative në fuqi (urdhëra dhe udhëzime), lidhur me emërtesat e hallkave të strukturës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si më poshtë:

3.1 Në pikat 4, 6 e vijues të urdhrin nr. 154, datë 6. 09. 2007 "Për krijimin e njësisë së përbashkët hetimore për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit", emërtesa "*Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar*", **ndryshohet në "*Drejtoria së Kontrollit të hetimit dhe të Ndjekjes Penale*"**,

3.2 Në pikën 6 e vijues të urdhrin nr. 291, datë 21. 10. 2004 "Për funksionimin e Prokurorisë për Krime të rënda dhe marrëdhëniet e saj me Prokuroritë e tjera dhe me Policinë Gjyqësore", emërtesa "*Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar*" **ndryshohet në "*Seksioni Kundër Krimit të Organizuar*"**;

3.3 Në pikën 3.1 e vijues të urdhrin nr. 284, datë 19. 12. 2002 "Për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në Prokurori" dhe në pikën III-3 e vijues të udhëzimit nr. 289, datë 30. 12. 2002 "Për mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe plotësimit të evidencave statistikore në Prokurori", emërtesa "*Zyra e Statistikës*", **ndryshohet në "*Spektori i Statistikës*"**;

3.4 Në pikën 4.1 të urdhrin nr. 184, datë 16. 09. 2002 "Për caktimin e rregullave/procedurës së betimit të prokurorëve", emërtesa "*Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit*" **ndryshohet në "*Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore*"**,

3.5 Në pikat 9 e 10 të udhëzimit nr. 2, datë 15. 05. 2003 "Mbi hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore", emërtesa "Drejtoria e Krimin të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme" **ndryshohet në "Sektori Kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm";**

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA

Kon.Kom KL
28.01.08

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized circular flourish followed by the name 'RAMA' written in a cursive script.

